



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 prill 2024
Nr. ref.:MK 2418/24

MENDIM KONKURRUES

i gjyqtarit

RADOMIR LABAN

në

rastin nr. KI70/23

Parashtrues

Xhemile Ademi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës
Ac. nr. 835/19 të 11 nëntorit 2022**

Duke shprehur që në fillim respektin tim me mendimin e shumicës së gjyqtarëve në këtë rast, të cilët me shumicë votash konstatuan se Aktgjykimi Ac. nr. 835/19 i Gjykatës së Apelit të Kosovës i 11 nëntorit 2022, nuk është në mënyrë aktive i diskutueshëm sepse është anuluar me aktvendimin e Gjykatës Supreme të 7 qershorit 2023, dhe çështja e kërkesëpadisë së saj është kthyer në Gjykatën Themelore për rigjykim. Dhe për rrjedhojë, aktgjykimi para kësaj gjykate nuk është më në fuqi dhe si i tillë nuk prodhon asnjë efekt juridik për parashtruesen e kërkesës.

Mirëpo, unë si gjyqtar i vetëm kam një mendim konkurrues për konkluzionin e shumicës dhe nuk pajtohem me mendimin e shumicës edhe pse e konsideroj rastin të papranueshëm.

Unë si gjyqtar pajtohem me gjendjen faktike siç është deklaruar dhe paraqitur në vendimin për hedhje poshtë dhe e pranoj të njëjtën gjendje faktike si të saktë. Gjithashtu, Unë si gjyqtar pajtohem me mënyrën se si janë parashtruar dhe paraqitur pretendimet e parashtrueses së kërkesës në vendimin për hedhje poshtë dhe i pranoj të njëjtat si të sakta.

Megjithatë, nuk pajtohem me analizën ligjore dhe qëndrimin e shumicës se rasti nuk është më një kontest aktiv. Konsideroj se kjo analizë ligjore është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me praktikën e vetë Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu konsideroj se kjo analizë dhe konkluzion i shumicës është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me detyrimin e Gjykatës që, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, i cili e detyron Gjykatën që *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”* Duke e theksuar këtë, nuk dua t'i referohem një rasti individual të GJEDNJ-së, por një udhëzuesi praktik për kushtet e pranueshmërisë së GJEDNJ-së në të cilin nuk ka asnjë rast të vetëm në të cilin GJEDNJ ka deklaruar rastet që nuk janë vendosur në merita në dobi të parashtruesit të kërkesës si raste joaktive, përkatësisht pa objekt, përkundrazi, praktika e GJEDNJ-së tregon të kundërtën.

Për sa më sipër dhe në pajtim me rregullin 57 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, për të ndjekur dhe shpjeguar më lehtë dhe qartë mendimin tim konkurrues, së pari (I) do t'i paraqes rastet e referuara nga gjykata (II) do të rikujtoj pretendimet e parashtrueses së kërkesës (III) arsyetoj pse nuk pajtohem me rastet e përmendura nga Gjykata në vendimin për hedhje poshtë (IV) dhe më pas do të shtjelloj kushtet e pranueshmërisë në lidhje me moshterim dhe (V) të paraqes përfundimin tim për objektin e kontestit.

I Rastet në të cilat thirret Gjykata;

Rastet e referuara nga Gjykata rastin konkret janë të pazbatueshme dhe, për mendimin tim, janë interpretuar gabimisht, përkatësisht (shih rastet e GJEDNJ-së *El Majaoui & Stichting Touba Mosque kundër Holandës*, kërkesa nr. 25525/03, vendim për heqje nga lista, paragrafi 30, *Pisano kundër Italisë*, kërkesa nr. 36732/97, vendim për heqje nga lista, paragrafi 42, *Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë*, kërkesa nr. 60654/00, vendim për heqje nga lista, paragrafi 97). Të gjitha këto raste kërkojnë që të plotësohen dy kushte, përkatësisht (i) së pari, nëse ekzistojnë ende rrethanat për të cilat janë ankuar drejtpërdrejt parashtruesit e kërkesës; dhe, (ii) së dyti, nëse efekti i një shkeljeje të mundshme të Konventës për shkak të këtyre rrethanave gjithashtu është hequr .

Gjithashtu, konsideroj se rastet e Gjykatës Kushtetuese janë plotësisht të pazbatueshme (KI195/18, me parashtrues *Afrim Haxha*, vendim për hedhje poshtë të kërkesës të 23 korrikut 2019, paragrafët 24-26, të cituara më lart, paragrafi 30, shih gjithashtu rastin e Gjykatës KO98/20, me parashtrues *Hajrulla Çeko dhe 29 deputetë të tjerë*, vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit nr. 52/2020, vendim për heqje të kërkesës nga lista, të 20 nëntorit 2020, paragrafi 85).

II Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

Rikujtoj se parashtruesja e kërkesës deklaroi se me aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Në pretendimet e saj, parashtruesja e kërkesës konsideron se aktgjykimi [C. nr. 627/18] i Gjykatës Themelore dhe aktgjykimi [Ac. nr. 835/19] i Gjykatës së Apelit përmbajnë shkelje të të drejtave të njeriut të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, për shkak se Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ndonëse e njëjta gjykatë e kishte pranuar më parë ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe e kishte kthyer rastin për rigjykim, duke theksuar se çështja e ngritur në padi nuk është marrëdhënie pune, por e drejtë për të fituar të drejtën e ushqimisë dhe mbajtjes, e cila nuk skadon.

Parashtruesja e kërkesës thekson se Gjykata Themelore nuk e ka marrë parasysh vërejtjen e Gjykatës së Apelit dhe sërish ka refuzuar si të pabazuar padinë e parashtrueses së kërkesës, gjë që parashtruesja e kërkesës e konsideron shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.

III Analiza ligjore bazuar në rastet e mësipërme

Duke iu rikthyer analizës ligjore të kërkuar nga rastet e sipërpërmendura, konsideroj se në thelb pyetja e parë që gjykata do t'i duhet të përgjigjet është (i) nëse ende ekzistojnë rrethanat për të cilat ankohet parashtruesja e kërkesës ?

Konsideroj se parashtruesja e kërkesës ankohet për fitimin e të drejtës së mbajtjes dhe se gjykata ende nuk ka vendosur në merita.

Një pyetje tjetër që gjykata duhet t'i përgjigjet, sipas mendimit tim, është (ii), nëse është hequr edhe efekti i një shkeljeje të mundshme të Konventës për shkak të këtyre rrethanave?

Konsideroj se jo sepse më 7 qershor 2023, Gjykata Supreme përmes aktvendimit [Rev. nr. 211/2023] e pranoi revizionin e parashtrueses së kërkesës si të bazuar dhe si rezultat i kësaj i anuloi aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit dhe e ktheu lëndën në Gjykatën Themelore për rigjykim. Gjykata Supreme në aktvendimin e saj ka përcaktoi se për shkak „të zbatimit të gabueshme të së drejtës materiale dhe për shkak të shkeljes së rregullave procedurale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjyimit të goditur, prandaj e aprovon revizion dhe e anulon tërësisht aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë, dhe çështjen ia dërgon për rigjykim gjykatës së shkallës së parë“.

Nga kjo konkludoj se parashtruesja e kërkesës ka ende një kontest aktiv para gjykatës që nuk është zgjidhur në merita.

IV Kriteret e pranueshmërisë në lidhje me shterimin

Më tej, konkludoj se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar që konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht aktgjykimin Ac. nr. 835/19 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të 11 nëntorit 2022. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka specifikuar se cilat të drejta dhe liri themelore konsideron se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka parashtruar kërkesën në pajtim me afatet të cilat janë të përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

Në vijim, i referohem rregullit 34 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton se:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) Janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktit të kontestuar”

Rrjedhimisht, rikujtoj se sipas paragrafit 1 të nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit, çdo individ ka të drejtë të kërkojë mbrojtje juridike nga Gjykata Kushtetuese nëse mendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë nga një autoritet publik. Sipas paragrafit 2 të njëjtit nen, një person mund të parashtrtojë parashtresën e lartpërmendur vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike të përcaktuara me ligj.

Lidhur me kërkesën konkrete përkitazi me plotësimin e kushteve të cekura, theksoj se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston aktin e një autoriteti publik,

përkatësisht Aktgjykimin Ae. nr. 835/19 e Gjykatës së Apelit të Kosovës të 11 nëntorit 2022. Megjithatë, më tutje do të vlerësoj nëse parashtruesja e kërkesës e ka përmbushur kushtin e shterimit të mjeteve juridike të përcaktuar me ligj, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës.

Në mbështetje të kësaj, fillimisht theksoj që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike. Më saktësisht, bazuar në nenin 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, Gjykata mund ta deklarojë kërkesën të papranueshme nëse gjatë vlerësimit paraprak konstaton se kërkesa e parashtruar qartazi nuk i plotëson kushtet procedurale të dorëzimit të kërkesave, siç përcaktohet me nenin 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës.

Pikërisht në lidhje me këtë theksoj, se kushtet për të vlerësuar nëse janë përmbushur detyrimet për të shteruar të gjitha “*mjetet efektive juridike*” janë të përcaktuara mirë në praktikën e GJEDNJ-së, në përputhje me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Rikujtoj se praktika e GJEDNJ-së dhe e kësaj Gjykate njeh tri kategori të rasteve kur kërkesa e paraqitur mund të shpallet e papranueshme për shqyrtim për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike dhe ato janë; **i**) “mosshterimi procedural”, (shih rastet e GJEDNJ-së [Civet kundër Francës](#) [DHM], nr. 29340/95, Aktgjykim i 28 shtatorit 1999, paragrafi 41; [Pagerie kundër Francës](#), nr. 24203/16, Aktgjykim i 19 prillit 2023, paragrafi 143; [Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë](#) [DHM], nr. 24203/16, Vendim i 10 marsit 2010, paragrafët 69 dhe 97), **ii**) “mosshterimi substancial” (shih rastet e GJEDNJ-së [Haxhia kundër Shqipërisë](#), nr. 29861/03, Aktgjykim i 8 tetorit 2013, paragrafët 149 dhe 152; [Castells kundër Spanjës](#), nr. 11798/85, Aktgjykim i 23 prillit 1992, paragrafi 32; [Ahmet Sadik kundër Greqisë](#), nr. 18877/91, Aktgjykim i 15 nëntorit 1996, paragrafi 33; [Gäfgen kundër Gjermanisë](#) [DHM], nr. 22978/05, aktgjykim, i 1 qershorit 2010, paragrafët 142, 144 dhe 146), dhe, **iii**) “kërkesë e parakohshme”, (shih rastet e GJEDNJ-së [Bilsena ŠAHMAN kundër Bosnjës dhe Hercegovinës](#), nr. 40110/16, vendim i 25 prillit 2017; dhe [Mirazović kundër Bosnjës dhe Hercegovinës](#), nr. 13628/03, vendim i 16 majit 2006).

Në rastin konkret, vërej se parashtruesja e kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit Ae. nr. 835/19 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të 11 nëntorit 2022, i cili është anuluar me aktvendimin e Gjykatës Supreme të 7 qershorit 2023 dhe çështja e kërkesëpadisë së saj është kthyer në Gjykatën Themelore për rigjykim.

Duke pasur parasysh këtë, konstatoj se procedura gjyqësore e iniciuar nga parashtruesja e kërkesës është ende duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore. Kjo e cilëson kërkesën konkrete si kërkesë të kategorisë **iii**) “kërkesë e parakohshme”, që është në pajtim me praktikën e përmendur të GJEDNJ-së (shih rastet konkrete të GJEDNJ-së [Bilsena ŠAHMAN kundër Bosnjës dhe Hercegovinës](#), nr. 40110/16, vendim i 25 prillit 2017; [Mirazović kundër Bosnjës dhe Hercegovinës](#), nr. 13628/03, vendim i 16 majit 2006).

Në këtë drejtim, rikujtoj se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion kundër vendimit të kontestuar.

V. Përfundim në lidhje me mendimin konkurrues

Duke pasur parasysh sa më sipër, konstatoj se kërkesa e parashtrueses së kërkesës kualifikohet si kërkesë e kategorisë **iii)** “kërkesë e parakohshme”, dhe për rrjedhojë Gjykata duhet ta hedhë poshtë kërkesën në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Mendimi konkurrues është paraqitur nga gjyqtari;

Radomir Laban, gjyqtar

Më 27 mars 2024 në Prishtinë

